Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***20.05.2022***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***30.05.2022***	***Nr. i lëndës:*** ***149/2022***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.05.2022, operatori ekonomik **"Era Med H" sh.p.k –Malishevë**, ka parashtruar ankesë me nr: **149/22,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik **"KosovaMed Healthcare" sh.p.k-Prishtinë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"KUJDESI SOCIO-SHËNDETËSOR SHTËPIAK DHE AMBULATOR PËR QYTETARET E KOMUNËS SË MALISHEVËS"*** me nr.të prokurimit: 62500-22-469-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Malishevë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontrat publike kornizë- shërbim, vlera e madhe, Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 399, 670.00 €

Rinjoftim zyrtarë për ri-tenderim më datën 20.04.2022, sqarime të dosjes së tenderit me datën 22.04.2022, pyetje lidhur me ditën e hëne festë zyrtare më datën 22.04.2022, Kërkesa për rishqyrtim per të njëjtën çështje 22.04.2022, dorzimi i ofertave 25.04.2022, procesverbali i hapjes 25.04.2022, njoftimi i AK-së lidhur me

rekomandimin për kontratë 29.04.2022, kërkesë per qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontrat 04.05.2022, kërkesa për ri-shqyrtim të vendimit të AK-së, të datës 04.05.2022, vendimi mbi refuzimin e kërkesesë për ri-shqyrtim 10.05.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë

Neni 5,7, 44, 46, dhe 47 të LPP-së, si dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Paraqesim pretendimet tona ankimore lidhur me aktivitetin e prokurimit publik me të dhënat:

Titull: ***KUJDESI SOCIO-SHËNDETËSOR SHTËPIAK DHE AMBULATOR PËR QYTETARET E KOMUNËS SË MALISHEVËS"*** me nr.të prokurimit: 62500-22-469-2-1-1.

Duke u menduar në zbatushmeri të dispozitave të LPP-së, ne kemi dorëzuar kërkesë për ri-shqyrtim ende pa pranuar njoftimin për vendimin tuaj. Me arsyetimin se është shkelur afati për dorëzimin e tenderve në ditë të festave zyrtare "Festa Zyrtare Pashkët Ortodokse" datë 25.04.2022 ditë e Hënë dhe si i të tillë kemi parashtruar para afatit kërkesën duke aluduar se do të korrigjoni veprimin e juaj.

Duke parë që me datën 29.04.2022 keni marrë vendim lidhur me këtë procedur në parashtrojmë kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me mos korrigjimin e datës së hapjes dhe vendimin e juaj lidhur me vazhdimin e procedurës tenderuese.

Duke qenë pjesë e garës në këtë aktivitet të prokurimit gjatë ofertimit kemi dorëzuar ofertën tonë sipas programit të e-prokurimit në vendin tonë ne kemi ofertuar ne konsionrcium dhe si të tillë i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit.

Gjatë ngarkimit të dokumenteve kemi tejkaluar lidhjen e konsiorcimit bashkë me ofertën tonë. Por kemi dorëzuar të gjitha dokumentet procedualisht të kërkuara sipas LPP-së, marrëveshjen e konsiorcimumit dhe deklaratën e OE pjesëmarrëse. Dhe dokumentet e tjera si kërkesa nga FDT dhe projekti ne tersi.

Ajo çfarë duhet të theksohet është se në sistem ne kemi ngarkuar të gjitha dokumentet e kërkuara në përjashtim të 3 dokumenteve të cilat është kërkuara të jenë të noteruara. Ajo si dokumente ne i kemi ngarkuar por të pa noteruara sepse ishte vikend dhe e hëna festë zyrtare. AK nuk ka dhënë arsyetim se në cilën bazë ligjore ka anuluar ofertën tonë për shkak te mungesës se lidhjes se konsiorciumit ne sistemin e prokurimit ku

te gjitha dokumentet dhe marrëveshja janë të dërguara.

Një veprim i tillë ka ardhë për faktin se ofertomi është ndërlidh me ditën e hëne 25.04.2022, e cila ka qenë festë zyrtare dhe si e tillë nuk kemi qenë të sigurt në pjesëmarrje proceduralisht shkaku kohës sepse disa nga institucionet edhe private nuk punonin për shkak të festes zyrtare.

Ne jemi munduar që të kontaktojmë edhe me disa noter lidhur me disa dokumente të cilat AK kishte kërkuar qe te ishin të notëruara por për shkak të Festës Zyrtare nuk kishim mundësi që ti noteronim.

Në me datën 22.04.2022 ne kemi parashtruar shkresë zyrtare sipas sistemit të e-prokurimit lidhur me datën e dorëzimit të ofertave duke kërkuara që të sqarohet data e dorëzimit të ofertave pasi që sipas Lpp-së, nuk lejohet hapja e ofertave e as dorëzimi në ditët e festave këtë të thëna në nenin 5 të LPP-së.

E afati për hapje të ofertave edhe për 2 ditë sipas Ligjit për Prokurim Publik si dhe Reegullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pra deri me datë: 27.04.2022. Në rast se nuk veprohet konform kërkesës për sqarim për shtyrje të afatit atëherë do të ushtrohet Kërkesë për rishqyrtim tek AK dhe ankesë në OSHP për shkelje të dispozitave të LPP-së, dhe RRUOPP-së. "të shenuarit më lartë eshte nderlidhur edhe me kerkesen për ri-shqyrtim qe kemi ushtruar duke paralajmruar që të vendoset afati i ri i ofertimit.

Po të njeten datë 22.04.2022, kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim duke shpresuar në pezullim të procedures për dorzimin dhe hapjen e ofertave për shkak të arsyeve ligjore të thëna edhe më lart lartë.

Ndërlidhur me këtë ne presion të kohes kemi leshuar gabimin e lidhjes se ofertave vetem ne aspektin elektronik të sistemit të e-prokurimit. Pasi që nuk besonim se do te kete veprim procedural ne ditë festave zyrtare.

Ndër të tjerat dispozitat e Lpp-së thuhet se :

Neni 5

Kalkulimi i afateve kohore

1.Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

2.Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Një qeshtje tjeter me rendesi është formulari për deklarim apo plotësimin e cmimeve në pozicionet e kërkuara është then se:

Kujdesi paliativ-Vizitat në shtepi për pacientet e palëvizshëm dhe me veshtërsi ne qasje në IKPSSH. Pershkrim nga Statuti I QKMF dhe UA i MSH 04/2020

PARAMASA

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia per 24 muaj	Çmimi per njësi	Shuma me TVSH

Çmimet të cilat inkorporojnë elementet e materialeve si aparatura shëndetësore materiali për kujdesin shëndetësor pagat e shërbyesve ne parim kolona e shënuar me lartë krijon dhe ka krijuar mjegulli lidhur me kalkulimin dhe plotësimin e formularit në sistemin elektronik lidhur me llogaritjen apo mos llogaritjen e TVSH-së. Edhe nëse shërbimi si tillë është i përjashtuar nga TVSH nuk mund të konsiderohet si projekte që përjashton kalkulimin e TVSH për shkak se për implementimin e tije në tersi është dashur që OE të kenë ne pronësi edhe automjete punë për teren që ne fakte do të krijonin shpenzime të cilat ndërlidhen me TVSH-në. Që në konsultim me ATK na është thanë se një çështje e tillë është dashur te trajtohet si procedura e kombinuar me TVSH.

Pasi që OE i rekomanduar për kontratë në pozicionin ku thuhet se duhet të shënohet çmimi për njësi dhe shuma me TVSH është dashur te trajtohet sipas procedurës ligjore qe formulari është plotësuar gabim dhe te refuzohet ofertimi.

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Fq 90 thuhet se:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon

Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Kusht administrativ

Formulari për kalkulimin e ofertave nga OE i rekomanduar nuk është i vulosur që me dispozitat e LPP-së, është dashur mos pranohej pasi qe nuk përmban vulën e as nënshkrimin e personit përgjegjës të OE te rekomanduar për kontratë.

Dhe nga e gjithë kjo procedura nga AK nuk është cilësuar si procedurë e përshpejtuar qe ne fakte është

tejkaluar rregulli ligjor i thëne ne dispozitat e LPP-së ne nenin 44-45-46, si dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik paragrafi 50.6.50.7.

Duke u bazuar në të thënat më lartë kërkojmë nga AK Komuna Malishevës që të pranoj kërkesën tonë ta anuloj aktivitetin e prokurimit. Në komunikim me Krpp-në ne kemi pyeture për dorëzimin e ofertave në ditë të festave zyrtare dhe na është thënë se një veprim i tillë është në kundërshtim me LPP, parimet primare dhe sekondare të ndërlidhura me prokurimin publik.

Duke parë që AK Komuna e Malishevës nuk është duke ndërmarr hapa për pezullim të procedurës ne me datën 04.05.2022, kemi bërë kërkesë për qasje në ofertën e rekomanduar për kontratë duke mos pasur qasje të tërësishme në dokumentet e ofertës për shkak të konfidencioalitetit ne morëm disa nga dokumentet e OE te rekomanduar për kontratë.

Me dosjen te tenderit nder te tjerat kritere e renditura AK kishte kërkuar që OE të ketë:

Licenca nga AKPM si Qarkullues me Shumice i Produkteve Farmaceutike.

Provë Kërkesa në dosjen e tenderit :

OE i rekomanduar kishte prezantuar një Licencë e cila është: Me titull Qarkullues me shumicë për paisje medicionale me numër L1PM-0050/01/02/2019 e cila është në kundërshtim më kërkesën e AK-së.

Dhe si e tillë edhe procedura për marrjes e këtyre licencave dallon në tersi. Si dhe veprimtarit dallojnë në tersi pasi që:

Pasi që Licenca për Qarkullues me Shumicë për Paisje Medicionale ka të drejtë importin e pajisjeve medicionale por jo edhe të produkteve farmaceutike. Duke u bazuar në të thënat më lartë kërkojmë nga AK Komuna e Malishevës që të pranoj kërkesën tonë ta anuloj aktivitetin e prokurimit. Në komunikim me Krpp-në ne kemi pyeture për dorëzimin e ofertave në ditët të festave zyrtare dhe na është thënë se një veprim i tillë është në kundërshtim me LPP, parimet primare dhe sekondare të ndërlidhura më prokurim publik.

Teksti i shënuar më lartë ishte i shënuar në kërkesën për rishqyrtim të cilën AK Komuna e Malishevës nuk e ka trajtuar as një pretendimet tona ankimore duke mos na dhen as një arsyetim ligjor për vendimin e saj.

Andaj kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Eksperti shqyrtues qe ti pranoj pretendimet tona dhe të anuloj vendimin e AK-Komuna e Malishevës.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

		Kërkesat e përshtatshmërisë: **1.Përshtatshmëria e OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr.04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092– deklarata nën betim.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **a.Përshtatshmëria e OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr.04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092– deklarata nën betim.** **a.Një deklaratë nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri të Ligjit Nr.04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, Neni 65-e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneksi 2 në dosjen**
		2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit	**b)Vertetimi nga Administrata Tatimore duhet te dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për kontratë.**
		3.Një vërtetim nga autoriteti kompetent gjyqësor i vendit te themelusit të tenderuesit (GjTHK) se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me Kërkesat e pershtatshmerise Pika 6.2 .nën a,c,d,e,f dhe pika 6.3 nen a.b. dhe d. të dosjes se tenderit (deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit).	**c)Vërtetimin nga Gjykata - duhet te dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për kontrate. Në rast të dështimit të dorëzimit të dokumenteve nën pikën b. dhe c. tenderi në fjalë do të refuzohet.**
Kërkesat e përshtatshmërisë	7.1 &	**Përshtatshmëria**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

profesionale	7.2	**profesionale:** **1.Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve**	**1.Vërtetimi nga Ministria për regjistrim çertifikata e biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara**
		2.Regjistrimi i numrit fiskal ne ATK	**2.Regjistrimi i numrit fiskal**
		3.Certifikata e TVSH-së	**3.Certifikata e TVSH-së**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, në vlerë jo më pak se 400,000.00 €.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Raportin apo raportet përkatëse nga një ose më shumë banka per tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë që e pasqyrojn kete qarkullim**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1 Stafi i angazhuar për këtë projekt duhet të jenë sipas projektit e bashkengjitur në DT.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1 Lista e stafit –origjnal , stafi profesional duhet te kete licencen te bashkangjitur me Kontratën ose marrveshjen parparake per angazhimin e tij ne kete projekt - KOPJE , ndersa per stafin teknik kontratat ose marrveshjen parparake per angazhimin e tij ne kete**
		2 Të paraqiten paisjet e domosdoshme sipas projektit te bashkengjitura ne dosjen e tenderit.	**2 Lista origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik e pajisjeve – mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e shërbimeve - Lista e paisjeve – origjinal , për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje deshmi (librezat-ose fatura, ose DUD-i – Njerin prej tyre ose ndonjë deshmi tjeter plotesuese) , që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytezimin e tyre me qera) Për gjithë këto produkte, pajisje dhe mjete OE duhet të ofroj plann e furnizimit, sasia dhe inf. tjera. - Libreza**

			e regjistrimit të automjetit te cilat regjistrohen duhet te jete me afate te regjistrimit- kopje e noterizuar; - Për pajisje tjera te dëshmohen me dokumente relevante valide.
		3 - OE duhet te jete i pajisur me Certifikatë ISO 9001 2015 (per sherbime socio-shendetesore)	**3 Kopje e noterizuar e certifikatës ISO 9001 2015 - valide**
		4 - Te dëshmohet se OE është i regjistruar ne AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike	**4 - Licenca nga AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike (me validitet) - Kerkohet kopje e notorizuar.**
		5 - Staf te kualifikuar per mirembajtje dhe leshuarje ne pune te paisjeve te cilat jane objekt i kesaj kontrate.	**5 - Staf i kualifikuar me certifikat origjinale nga ndonje prodhues, valid per instalim-servisim-mbikqyrje te pasijeve qe eshte objekt i kesaj kontrate.- Kopje e noterizuar**
		6 - Certifikata ose veprimtari - Aktivitet e mjekesise se praktikes se pergjithshme - Aktivitete mjeksise se specializuar - Aktivitete ne shtepite e kujdesit per te moshuarit dhe persona me nevoja te vecanta - Aktivitetet e kujdesit social pa akomodim per te moshuarit dhe persona me nevoja te vecanta - Aktivitete e tjera te kujdesit social pa akomodim - Aktivitete tjera te shendetit te njeriut - Aktivitete e perkujdesjes infermierike ne shtepi	**6 - Operatori Ekonomik duhet te posedoje certifikate licencimi ose veprimtari per ofrimin e sherbimeve sociale, shendetesore, perkujdesje shendetesore per te moshuar dhe familjare.- Kopje e noterizuar**
		7.Të paraqitën Kontratat e sherbimeve të natyrës se ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për	**7.Lista e Kontratave- origjinale - të natyrës së ngjajshme , kopjet e kontratave te bashkangjitura me (raportet e pranimeve ose proceseve te pranimeve ose referencave- njeren prej tyre) ne 3 vitet e fundit, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i**

		kontratë min 400.000€	**prokurimit, viti, titulli etj, institucioneve publike ose proceset e pranimeve nga personat privat. Mirenjohje nga ndonjë institucion ose nga qeveria per punën e OE.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 29.04.2022, është konstatuar si në vijim: AK-Komuna Malishevë, shpërblen me kontratë operatorin ekonomik "KosovaMed Healthcare" sh.p.k -Prishtinë**,** më çmimin e ofruar prej 399,540.00 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, kontratë publike kornizë- shërbim, vlera e madhe. Kriteri për dhënien e kontratës, Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

Fillimisht sqarojmë se kjo procedure e prokurimit ka qene objekt shqyrtimi ne OSHP, përkatësisht ekzistojnë raportet e ekspertizës me numër 15/22 dhe 45/22, ku në herën e parë ishin kontestuar kriteret e përcaktuar në njoftimin për kontratë. Më pas AK- Komuna Malisheve, ka anuluar në tersi këtë aktivitet të prokurim, per kundër faktit se OSHP, përkatësisht Paneli Shqyrtues ende nuk ka nxjerr Vendim.

Rrjedhimisht AK – Komuna Malisheve, inicon procedur te re te prokurimi e cila përsëri është kontestuar dhe për të njëjtën është nxjerr raport i ekspertizës me nr 45/22, ku eshte kerkuar rishqyrtim i ofertave ne kuptim te nenit 108/A, të LPP-se, ku edhe kundrejt këtij raporti PSH, ende nuk ka nxjerr vendim.

Dispozitat e nenit 111, te LPP-se, përcaktojnë kushtet kur OSHP, duhet ta pranoj dhe ta fus ne shqyrtim nje ankese, rrjedhimisht ne kemi pranuar autorizim për trajtim te kësaj ankese dhe po ti referohemi te dhënave te ngarkuara ne e-prokurim kundrejt këtij aktiviteti te prokurimit rezulton qe AK – Komuna Malisheve, fillimisht me datën 18.02.2022, e ka pezulluar ketë aktivitet te prokurimit. Mirëpo, sipas nenit 112 te LPP-se autoritet për heqje te pezullimit ka vetëm Kryetari i OSHP-se dhe atë pas kërkesës se AK-se. Një kërkesë e tille nuk

është bere nga AK. Po ashtu edhe me datën 06.05.2022, përsëri është pezulluar aktiviteti i prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "Era Med H" sh.p.k –Malishevë

Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se AK – Komuna Malisheve, sipas procesverbalit te hapjes, hapja e ofertave është bere me datën 25.04.2022, date e cila sipas kalendarit ka qene fest zyrtare ne Republiken e Kosoves.

Parashtruesi i ankesës, me datën 22.04.2022, përmes kërkesës për informacione shtese ka kerkuar nga AK qe te beje shtyrjen e afatit per hapje te ofertave duke arsyetuar se e njëjta ditë e përcaktuar per hapje është festë zyrtare. AK me të njëjtën date ishte përgjigje me anë të shkreses ku ishte arsyetuar se *"ky aktivitet i prokurimit është duke u trajtuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik për shkak se nuk është trajtuar me kohë në OSHP ne jemi të obliguar që të vazhdojmë për arsye se qytetaret e Komunës së Malishevës kanë nevojë të madhe për shërbimet shëndetësore sepse QKMF në Malishevë nuk kanë kapacitet për kryerjen e shërbimeve në përputhje me kërkesat e qytetarëve. Dosja është e njëjtë për të gjithë OE të interesuar dhe kriteret janë në përputhje me ligjin nuk janë kritere diskriminues dhe ju mund të paraqitni ofertën tuaj pran AK Komuna Malishevë në e-prokurim ".*

Përkundër kërkesës për rishqyrtim dhe kërkesë për informacione shtese për shtyrjen e afatit, AK bënë hapjen e ofertave me datë 25.04.2022 në ora 14:00h, ashtu siç kishe planifikuar ku veprimi si i tillë është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe Rruopp, përkatësisht nenin 5, Kalkulimi i afateve kohore ku qartë është specifikuar:

"*1.Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në* ***një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune****. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit."*

2.Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një ***festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.***

Gjithashtu, Neni 47 i LPP-së "Fillimi i Afatit Kohor për Pranimin Kërkesave për Pjesëmarrje dhe Tenderëve ka përcaktuar " *1.Afatet kohore të caktuara në nenin 44 - 46 të këtij ligji* ***do të kalkulohen në sipas Nenit 5*** *dhe fillojnë si në vijim".*

Per me tepër neni 36.pika d) Hapja e Tenderëve elektroni tek RrUOPP përcakton:

d) Pas pranimit të njoftimit nga paragrafi 36.12. pika c), Autoriteti Kontraktues obligohet të bëjë hapjen publike të ofertave më së voni 48 orë nga pranimi i njoftimit dhe në qoftë se afati skadon në ditën e shtunë, të diele ***apo në një ditë feste***, ***hapja publike do të bëhet në ditën e parë të ardhshme të punës***.

OE ankues, ka ngritur pretendime ankimore edhe kundër ofertës se OE tani të rekomanduar për dhënie te kontratës si dhe kundër arsyetimit te eleminimit.

Po ti referohemi shkresave të lendes, përkatësisht ofertës se OE te rekomanduar per dhënie te kontratës dhe te operatorit ekonomik ankues, rezulton qe AK – Komuna Malisheve, vlerësimin e ofertave pervec se nuk e ka bere konform dispozitave te nenit 59 te LPP-se, po ashtu ka shkelur edhe parimet kryesore te LPP-se perfshir edhe neni 7 të LPP-se. AK Komuna Malisheve, ka rekomanduar për dhënie te kontratës operatorin ekonomik i cili për kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht pozicionin nr. 4, ku eshte kerkuar te dëshmohet se OE me Licence nga AKPM si qarkullues me shumice i **produkteve farmaceutike**. I njëjti OE ne ofert ka prezantuar Licence, te lëshuar nga AKPM si qarkullues me shumic për **paisje medicinale**, rrjedhimisht AK, te njëjtin ka qene dashur ta trajtoj si oferte te pa pergjegjeshme, ndërsa operatorin ekonomik ankues, për kundër faktit se i njëjti ka ofertuar me licence te AKPM-së si qarkullues me shumice **për produkte dhe paisje medicionale**, i njeti eshte kualifikuar si i pa pergjegjeshem për disa arsye, ku një prej tyre ceket për mungesë te licencës, edhe pse disa prej arsyeve janë të pa baza, shembull është potencuar se i njëjti nuk ka ofertuar ne grup por si i vetëm, ndërsa i njëjti ne oferte posedon marrëveshje të krijimit te grupit.

Andaj, bazuar ne atë qe u tha si me larte, shkeljeve procedurale dhe ligjore, propozimi yne per AK – Komuna Malisheve, eshte qe kjo procedurë e prokurimit te anulohet ne tërësi dhe nëse e njëjta ri tenderohet, të aplikohen kërkesa konkrete dhe relevante lidhur me natyrën e aktivitetit te prokurimit, siç parashihet me paragrafin 3, te nenit 51, te LPP-se, përkatësisht vlerësimi i ofertave te behet konform parimeve për prokurim publik dhe nenit 59 te LPP-se. Perveç kësaj, kërkesat e pershtatshmërisë te mos vendosen tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional. Nëse AK e ka me urgjencë këtë aktivitet të prokurimit siç e ka potencuar, LPP ka paraparë edhe procedura tjetra të prokurimit të cilat mund të aplikohen dhe të arsyetohen në KRPP.

<u>Provë: bashkangjitur me raport gjeni kopje :</u> **Kërkesa për informacione shtesë për shtyrje të afatit për hapjen e ofertave dhe përgjigjja e AK .** **Procesverbali i hapjes se tenderit.** **Kalendari i festave zyrtare në Republiken e Kosovës për vitin 2022.** **Licenca e veprimtarisë të OE të rekomanduar për kontratë dhe Licenca e veprimtarisë të OE ankues** **Marrëveshja për krijimin e grupit**

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, te anulohet ne tërësi aktiviteti i prokurimit *"KUJDESI SOCIO-SHËNDETËSOR SHTËPIAK DHE AMBULATOR PËR QYTETARET E KOMUNËS SË MALISHEVËS".*

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna Malishevë
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
  OE ankues - "Era Med H" sh.p.k –Malishevë